



GTS-Gazra Teknike Shqiptare Sh.p.k
Pasqyrat Financiare
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

Përbajtja

Raporti i Auditimit	3-5
Pasqyra e Pozicionit Financiar	6
Pasqyra e Performancës	7
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto	8
Pasqyra e Rrjedhjes së Mjeteve Monetare	9
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare	10-22

Raport i Audituesit të Pavarur

Drejtuar Pronarit dhe Drejtimit të GTS-Gazra Teknike Shqiptare Sh.p.k

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të GTS-Gazra Teknike Shqiptare Sh.p.k ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financier më 31 dhjetor 2017 dhe pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyrën e rrjedhjes së mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe një përbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënimë të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financier të Shoqërisë më datë 31 dhjetor 2017 si edhe të performancës së saj financiare dhe rrjedhën e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit ("SKK").

Baza për opininin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrin e emërtuar "*Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*" të këtij raporti. Ne shprehim pavarsinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe Palëve të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, si edhe sistemin e kontrollit të brëndshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësисë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshne, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësисë, përvëç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likujdojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përvëçse sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojme gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazaë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie material, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësimë të qëllimshme, keqinterpretim, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontolleve të brëndshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinionin mbi efektivitetin e sistemeve të kontolleve të brëndshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyestuehmërinë, e çmuarjeve kontabël si edhe paraqitjen e shënimive shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet teë tërheqim vëmëndjen në reportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare (vazhdim)

Ne komunikojmë me drejtimin e GTS-Gazra Teknike Shqiptare Sh.p.k, ku përveçse çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikuar gjatë auditimit tonë.

Auditues ligjor
Margarita Kalemasi

02 Mars 2018
Tiranë, Shqipëri

I.E.K.A **Margarita KALEMASI**
Ekspert kontabel te
autorizuar
Liçence Nr. 156

Rr. Asim Vokshi
Nd. 14, H. 6, Ap. 27
Kod Postar 1016
Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 242 0666
m.kalemasi@joncon.al

GTS-Gazra Teknike Shqiptare sh.p.k

Pasqyra e Performancës për vitin që mbyllt më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përvçese kur shprehet ndryshe

Pasqyra e Pozicionit Financiar

AKTIVET	Note	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Aktivet afatgjata			
Aktivet afatgjata materiale	4	299,693,624	274,505,311
Aktivet afatgjata jomateriale	5	31,729,277	13,900,728
Totali i aktiveve afatgjata		331,422,902	288,406,039
Aktivet afatshkurtra			
Mjetet monetare	6	130,064,682	93,074,359
Llogari të arkëtueshme, klientë	7	354,372,957	343,097,296
Llogari të arkëtueshme, tatimore	8	40,891,399	23,484,985
Inventarë	9	69,740,729	71,746,338
Totali i aktiveve afatshkurtra		595,069,767	531,402,979
TOTALI I AKTIVEVE		926,492,668	819,809,018

DETYRIMET DHE KAPITALI

Kapitali

Kapitali i nënshkruar	10	292,164,000	292,164,000
Rezerva ligjore	11	8,905,635	8,905,635
Rezerva të tjera	11	265,503,500	265,503,500
Fitimi i pashpërndarë		180,096,184	112,676,757
Fitimi neto i viti		48,945,272	67,419,428
Totali i kapitalit		795,614,591	746,669,319

Detyrimet afatshkurtra

Llogari të pagueshme, furnitorë	12	122,092,840	63,759,204
Llogari të pagueshme të tjera	13	4,291,168	2,613,070
Totali i detyrimeve afatshkurtra		126,384,008	66,372,274

Detyrimet afatgjata

Qiraja financiare	14	4,494,069	6,767,425
Totali i detyrimeve afatgjata		4,494,069	6,767,425
Totali i Detyrimeve		130,878,069	73,139,699
TOTALI I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE		926,492,668	819,809,018

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet bashkë me shënimet shpjeguese në faqet 10 – 22 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare. Pasqyrat financiare të Shoqërisë më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 janë aprovuar nga drejtimi më 28 shkurt 2018 dhe firmosur nga:

Hartuesi i Pasqyrave Financiare

Elona Hoshafi



Administratori

Giovanni Annoni

Matteo Fumagalli Romari

6

GTS-Gazra Teknike Shqiptare sh.p.k

Pasqyra e Performancës për vitin që mbylljet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përvçese kur shprehet ndryshe

Pasqyra e Performancës

Të ardhurat	Shënim	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Të ardhurat	15	824,455,660	775,135,929
Kosto e mallrave të shitur	16	(456,618,209)	(473,132,241)
Fitimi bruto		367,837,451	302,003,688
Shpenzime administrative dhe operative	17	(224,192,673)	(171,894,274)
Shpenzime amortizimi	4	(50,727,603)	(37,474,829)
Shpenzime financiare, neto	18	(4,766,618)	(3,582,545)
Shpenzime të tjera	19	(25,982,701)	(8,274,806)
Totali i shpenzimeve		(305,669,595)	(221,226,454)
Fitimi para tatimit		62,167,856	80,777,233
Shpenzimi për tatum fitimin	20	13,222,584	13,357,806
FITIMI NETO I VITIT		48,945,272	67,419,428

Pasqyra e performancës financiare duhet të lexohet bashkë me shënimet shpjeguese në faqet 10 – 22 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



GTS-Gazra Teknike Shqiptare sh.p.k

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital për vitin që mbylllet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përvçese kur shprehet ndryshe

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

	Kapital i nënshkruar	Rezerva	Fitimi i akumuluar	Fitimi i vitiit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2016	292,164,000	211,237,432		112,676,757	63,171,702
Totali i fitimeve gjithpërfshtirëse për vitin					
Fitimi i vitiit				67,419,428	67,419,428
Të ardhura të tjera gjithpërfshtirëse	-	-	-	-	-
Totali i fitimeve gjithpërfshtirëse për vitin	-	-	-	67,419,428	67,419,428
<i>Transaksionet me pronarët që regjistrohen direkt në Kapital</i>					
Transferime ndërmjet zërave të kapitalit	-	-	-	-	-
Kontributë nga pronarët	-	-	-	-	-
Totali i kontributeve dhe shpërndarjeve	-	-	-	-	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	292,164,000	211,237,432		112,676,757	130,591,130
Totali i fitimeve gjithpërfshtirëse për vitin				48,945,272	48,945,272
Fitimi i vitiit				48,945,272	48,945,272
Të ardhura të tjera gjithpërfshtirëse	-	-	-	-	-
Totali i fitimeve gjithpërfshtirëse për vitin	-	-	-	48,945,272	48,945,272
<i>Transaksionet me pronarët që regjistrohen direkt në Kapital</i>					
Transferime ndërmjet zërave të kapitalit	-	-	-	67,419,428	(67,419,428)
Kontributë nga pronarët	-	-	-	-	-
Totali i kontributeve dhe shpërndarjeve	-	-	-	67,419,428	(67,419,428)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	292,164,000	211,237,432		180,096,185	112,116,982
					795,614,591



GTS-Gazra Teknike Shqiptare sh.p.k

Pasqyra e Rrjedhjes së Mjeteve Monetare për vitin që mbyllt më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përvçse kur shprehet ndryshe

Pasqyra e Rrjedhjes së Mjeteve Monetare

CASH FLOWS NGA AKTIVITETE OPERATIVE	Note	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Fitimi i vitit		48,945,272	67,419,428
<i>Rregullime për:</i>			
Amortizimi	4	50,727,603	37,474,829

Ndryshime në:

- Inventarë	9	2,005,609	(38,304,106)
- Llogari të arkëtueshme	7,8	(28,682,075)	(8,149,075)
- Llogari të pagueshme	12,13	60,011,726	(22,906,764)
Cash flow i gjeneruar nga aktivitet operative		133,008,135	35,534,312

CASH FLOWS NGA AKTIVITETET

INVESTUESE

Blerja e aktiveve afatgjata	4	(93,744,466)	(103,053,006)
Cash flow i gjeneruar nga aktivitet investuese		(93,744,466)	(103,053,006)

CASH FLOWS NGA AKTIVITETET

FINANCUESE

Pagesa e huave	14	(2,273,355)	3,665,019
Cash flow i gjeneruar nga aktivitet financuese		(2,273,355)	3,665,019

RRITJE (RËNIE) NË CASH

CASH NË FILLIM TË VITIT

CASH NË FUND TË VITIT

Pasqyra e rrjedhjes së mjeteve monetare duhet të lexohet bashkë me shënimet shpjeguese
në faqet 10 – 22 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



GTS-Gazra Teknike Shqiptare sh.p.k

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që mbylllet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përvèçse kur shprehet ndryshe

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

GTS-Gazra Teknike Shqiptare Sh.p.k ("Shoqëria") është një shoqëri e themeluar dhe e regjistruar në Shqipëri. Adresa e Shoqërisë është Vaqarr, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria është regjistruar me NUIS J61905015B dhe aktualisht raporton pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

Shoqëria është e përfshirë në prodhimin, shitjen, dhe shpërndarjen e gazrave teknike, mjekësore dhe të veçanta, si dhe shitjen e pajisjeve dhe pjesëve të këmbimit në lidhje me biznesin kryesor. Shoqëria është themeluar në 18 Janar 1996 nga SOL S.p.A, një Shoqëri me bazë në Itali. SOL S.p.A është pronari i vetëm i Shoqërisë.

Drejtuesit e Shoqërisë janë Z. Giovanni Annoni dhe Z. Matteo Fumagalli Romario.

Më 31 dhjetor 2017 shoqëria kishte 25 të punësuar, (2016: 21 punonjës).

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

2.2 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lek, e cila është njëkohësisht dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrate financiare kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.



GTS-Gazra Teknike Shqiptare sh.p.k

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që mbylllet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përvçese kur shprehet ndryshe

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të përmendura më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetarë në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në Lekë me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit njihen përgjithësisht në fitime ose humbje.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

Monedha	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
1 EUR	132.95	135.23
1 USD	111.10	128.17
1 GBP	149.95	157.56

3.2 Instrumenta financiare

Instrumentat financiare jo-derivative përbëhen nga të drejta të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalente të tyre, llogari të financimeve të brendshme, llogari të pagueshme dhe detyrime ndaj palëve të lidhura.

Të gjitha aktivet dhe detyrimet financiare njohen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksi që lidhet me to. Pas njohjes fillestare, instrumentat financiare jo-derivative njihen siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument finansiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur mbarojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit finanziar ose kur shoqëria transferon aktivin finanziar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë mbarojnë, shfuqizohen ose anullohen.



GTS-Gazra Teknike Shqiptare sh.p.k

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që mbylllet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përvçese kur shprehet ndryshe

Mjetet monetare dhe ekuivalentët t tyre

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat bankare. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Të drejtat e arkëtueshme

Të drejtat e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Prodigjoni për zhvlerësimin e të drejtaave të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitet financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që të drejtat e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e prodigjonit llogaritet si diferenca midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të skontuara me normën e interesit efektiv.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Vlera e drejtë

Vlera e drejtë e vlerësuar për mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, të drejtat e arkëtueshme, llogaritë e pagueshme i përafrohen vlerës së tyre kontabël.

3.3 Aktivet afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Aktivet afatgjata materiale maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar. Kosto përfshin shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me përgatitjen e aktiveve në gjendje pune për qëllimin e përdorimin e tyre; shpenzimet e çmontimit dhe heqjes së elementeve dhe rikthimin e tokës në gjendjen origjinale. Programet (software) e blerë të cilët janë pjesë tërësore në funksionalitetin e pajisjeve përkatëse, kapitalizohen si pjesë e kësaj pajisje. Kur pjesë të një aktivi material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si të ndara (pjesë të rëndësishme). Fitimet dhe humbjet nga nxjerra jashtë përdorimit e ndonjë aktivi përcaktohen duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerra jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) të aktivit dhe pasqyrohen neto në zërin të ardhura të tjera të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata të trupëzuara i shtohet vlerës së mbetur të elementit nëse është e mundur që përfitimet ekonomike në të ardhmen që lidhen me ketë element do të rrjedhin në Shoqëri, dherë kostoja e tij mund të



GTS-Gazra Teknike Shqiptare sh.p.k

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllt më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përvçese kur shprehet ndryshe

matet me saktësi. Kostot e mirëmbajtjeve ditore të aktiveve afatgjata të trupëzuara njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet për të shpërndarë koston e aktiveve minus vlerën e tyre të mbetur gjatë jetës së dobishme dhe përgjithësisht njihet në të ardhura dhe shpenzime. Përmirësimet e ambienteve me qira amortizohen përgjatë afatit të qirasë. Aktivet në proces nuk amortizohen.

Jeta e dobishme e vlerësuar, normat e amortizimit të vitit dhe metodat e paraqitura më poshtë, janë zbatuar për peridhën aktuale dhe atë krahasuese.

• Ndërtesa	vlera e mbetur me 5%
• Automjete	vlera e mbetur me 20%
• Pajisje Zyre & Informatike	vlera e mbetur me 20 – 25%
• Aktivet jomateriale	vlera e mbetur me 15%

3.4 Provizonet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Shoqëria ka një detyrim ligjor ose konstruktiv, i cili mund të vlerësohet me besueshmëri dhe do të kërkojë flukse dalëse monetare të ardhshme për shlyerjen e tij. Provizonet përcaktohen duke skontuar flukset monetartë ardhshme të pritshme me një normë skontimi para tatimit, e cila reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.5 Njohja e të ardhurave

Shoqëria është e përfshirë në tregëtimin e energjisë elektrike. Të ardhurat njihen kur rreziqet dhe përfitimet nga pronësia i janë transferuar klientit, rimarrja e shumës është e mundëshme, kostot e lidhura dhe kthimet e mundshme mund të vlerësohen me besueshmëri dhe shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose për tu arkëtuar, neto nga kthimet. Për shitjen e energjisë, transferimi i rreziqeve dhe përfitimeve ndodh kur sasia aktuale e energjisë hidhet në rrjet dhe matet në pikën e shpërndarjes.

3.6 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesit nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në fitime ose humbje. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet për interesat nga huatë dhe humbjet nga kursi i këmbimit.

Të ardhurat nga interesit dhe shpenzimet e interesit njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv



GTS-Gazra Teknike Shqiptare sh.p.k

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që mbylllet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

3.7 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale njihet në fitim ose humbje, përveçse kur lidhet me elementë që njihen drejtpërdrejt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi i periudhës aktuale është tatimi i pritshëm për t'u paguar nga të ardhurat e tatushme, duke përdorur normat timore në fuqi ose thelbësishët në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullimi të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Shuma e tatimit aktual të pagueshëm ose të arkëtueshëm përfaqëson vlerësimin më të mirë të bërë të tatimit që pritet të paguhet ose arkëtohet dhe që reflekton pasiguritë që lidhen me tatim fitimin, nëse ka. Ky tatim llogaritet duke përdorur normën timore në fuqi ose të hyrë në fuqi në datën e raportimit. Tatim fitimi aktual përfshin gjithashtu çdo tatim që rezulton nga dividentët. Tatim fitimi aktual i pagueshëm ose i arkëtueshëm kompensohen vetëm në qoftë se kritere të caktuara përbushen.

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferenca të përkohshme ndërmjet vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimi.

Një aktiv tatem i shtyrë njihet për humbjen timore të papërdorur, kreditimet timore të papërdorura dhe diferençat e përkohshme të zbritshme deri në masën që është e mundur që të kenë fitime të tatushme në të ardhmen, kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Aktivet timore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është më emundur që përfitimi tatem të realizohet. Këto zvogëlime rimerren, kur mundësia e fitimit të ardhshëm tatem përmirësohet.

Tatimi i shtyrë matet me normat timore që pritet të zbatohen mbi diferençat e përkohshme kur të kthehen, në bazë të ligjeve në fuqi ose miratuar në datën e raportimit financiar. Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat timore që do duhet të ndiqen nga mënyra se si Shoqëria pret, në datën e raportimit, të rikuperojë ose shlyejë vlerën e mbartur të aktiveve ose detyrimeve të veta. Aktivi tatem i shtyrë kompensohet me detyrimin tatem të shtyre vetëm në qoftë se kritere të caktuara përbushen.



GTS-Gazra Teknike Shqiptare sh.p.k

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllt më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përvèçse kur shprehet ndryshe

4. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

Aktivet materiale	Ndërtesa	Pajisje dhe makineri	Pajisje industriale	Mjete transporti	Pajisje zyre informatike	Totali
Kosto						
Më 1 janar 2016	148,543,377	210,968,567	67,825,741	30,453,513	10,614,409	468,405,607
Shtesa	8,066,575	44,294,091	15,641,517	12,315,158	18,165,162	98,482,503
Pakësime		(713,220)	(2,204,806)	(4,250,205)	-	(7,168,231)
Më 31 dhjetor 2016	156,609,952	254,549,438	81,262,452	38,518,466	28,779,571	559,719,879
Shtesa	1,638,860	40,558,189	10,586,578	5,241,439	16,663,889	74,688,955
Pakësime	-	(2,758,855)	(1,558,092)	-	-	(4,316,947)
Më 31 dhjetor 2017	158,248,812	292,348,772	90,290,938	43,759,905	45,443,460	630,091,887
Zhvlerësim i akumuluar						
Më 1 janar 2016	(54,849,918)	(134,562,180)	(38,058,845)	(18,611,163)	(7,921,757)	(254,003,863)
Shpenzime për vitin	(4,741,211)	(19,062,079)	(7,091,977)	(3,589,232)	(692,080)	(35,176,579)
Pakësime		430,614	980,566	2,554,694	-	3,965,874
Më 31 dhjetor 2016	(59,591,129)	(153,193,645)	(44,170,256)	(19,645,700)	(8,613,838)	(285,214,568)
Shpenzime për vitin	(4,810,227)	(24,178,565)	(8,260,215)	(4,167,815)	(6,144,095)	(47,560,918)
Pakësime	-	1,360,593	1,016,631	-	-	2,377,224
Më 31 dhjetor 2017	(64,401,356)	(176,011,617)	(51,413,841)	(23,813,516)	(14,757,933)	(330,398,262)
Vlerësimi i mbartur						
Më 1 janar 2016	93,693,459	76,406,387	29,766,896	11,842,350	2,692,652	214,401,744
Më 31 dhjetor 2016	97,018,823	101,355,793	37,092,196	18,872,766	20,165,733	274,505,311
Më 31 dhjetor 2017	93,847,455	116,337,155	38,877,097	19,946,389	30,685,527	299,693,625



GTS-Gazra Teknike Shqiptare Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbylljet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përvëçse kur shprehet ndryshe

5. AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE

Aktivet jomateriale	Software dhe programe	Totali
Kosto		
Më 1 janar 2016	13,470,378	13,470,378
Shtesa	7,772,860	7,772,860
Pakësime	-	-
Më 31 dhjetor 2016	21,243,238	21,243,238
Shtesa	20,995,234	20,995,234
Pakësime	-	-
Më 31 dhjetor 2017	42,238,472	42,238,472
Zhvlerësim i akumuluar		
Më 1 janar 2016	(5,044,260)	(5,044,260)
Shpenzime për vitin	(2,298,250)	(2,298,250)
Pakësime	-	-
Më 31 dhjetor 2016	(7,342,510)	(7,342,510)
Shpenzime për vitin	(3,166,685)	(3,166,685)
Pakësime	-	-
Më 31 dhjetor 2017	(10,509,195)	(10,509,195)
Vlera e mbartur		
Më 31 dhjetor 2015	8,426,118	8,426,118
Më 31 dhjetor 2016	13,900,728	13,900,728
Më 31 dhjetor 2017	31,729,277	31,729,277

6. PARA NË ARKË DHE BANKË

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Para në arkë	52,130	120,368
Para në bankë në LEK	12,543,562	11,812,381
Para në bankë në Monedhë të huaj	117,468,989	81,141,610
Totali i parasë në arkë dhe bankë	130,064,682	93,074,359

Mjetet monetare dhe ekvivalentët e tyre përbëhen nga llogaritë në lekë dhe në euro që shoqëria ka pranë bankave të nivelit të dytë në Shqipëri si dhe gjëndja e arkës në datën e raportimit.



GTS-Gazra Teknike Shqiptare Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllt më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përvçese kur shprehet ndryshe

7. LLOGARI TË ARKËTUESHME

	31-12-2017	31-12-2016
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	34,527,627	18,122,149
Të arkëtueshme nga të tretët	319,845,330	324,975,147
Totali	354,372,957	343,097,296

8. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
TVSH e kreditueshme	40,891,399	23,399,989
Paradhënie	208,459	84,996
Totali	41,099,858	23,484,985

9. INVENTARI

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Mallra industrial	25,755,085	46,163,647
Mallra medikal	8,648,935	8,330,895
Gazra likuide	8,368,073	9,057,750
Produkte kimike	1,394,010	1,465,302
Gazra të tjera	25,574,625	6,728,745
	69,740,729	71,746,338

10. KAPITALI I PAGUAR

Më 31 dhjetor 2017 aksionar i vetëm i Shoqërisë është SOL S.p.A. Kapitali i Shoqërisë më 31 dhejtor 2017 dhe 2016 është 292.164.000,00 i përbërë nga një aksion me vlerë nominale prej 292.164.000,00 lekë.

11. REZERVA

Rezervat ligjore të krijuara nga Shoqëria deri më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 kanë një vlerë prej 8.905.635 lekë. Rezervat e tjera janë krijuar nga Shoqëria dhe nuk janë të detyrueshme prandaj nuk duhen konsideruar si rezerva ligjore. Rezervat e tjera të krijuara nga Shoqëria deri më 31 dhjetor 2017 kanë një vlerë prej 265.503.500 lekë.



GTS-Gazra Teknike Shqiptare Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllt më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përvèçse kur shprehet ndryshe

12. TË PAGUESHME NDAJ FURNITORËVE

Të pagueshme ndaj furnitorëve më 31 dhjetor 2017 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Llogari të pagueshme ndaj palëve të tjera	30,696,905	30,069,444
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	91,395,935	33,689,761
Totali	122,092,840	63,759,205

13. DETYRIME TË TJERA AFATSHKURTRA

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Kontributet shoqërore dhe shëndetësore	648,847	530,374
Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi	944,951	1,012,677
Tatimi i mbajtur në burim	164,750	133,335
Tatim fitimi	301,465	936,684
Pagat e punonjësve	2,231,155	-
Totali	4,291,168	2,613,070

14. HUA AFATGJATA

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Qiraja financiare	4,494,069	6,767,425
Totali	4,494,069	6,767,425

Qira financiare më 31 dhjetor 2017 në vlerën 4,494,069 lekë përfaqëson detyrimin ndaj Raiffeisen Leasing për financimin për blerjen e disa automjeteve të Shoqërisë.

15. TË ARDHURAT

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Shitje gazrash	651,150,806	613,013,285
Transport	84,281,800	85,952,200
Aktivitete të tjera	89,023,055	76,170,444
Totali	824,455,660	775,135,929

16. KOSTO E MALLRAVE TË SHITUR

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Gjëndje në fillim	71,746,338	33,442,233
Blerje gjatë vitit	454,612,600	511,436,347
Gjëndje në fund	(69,740,729)	(71,746,338)
Totali KMSH	456,618,209	473,132,241



GTS-Gazra Teknike Shqiptare Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllt më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përvçese kur shprehet ndryshe

17. SHPENZIME ADMINISTRATIVE

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Shpenzime transporti	84,662,777	54,572,431
Shpenzime për punonjësit	35,588,838	30,688,322
Shpenzime për të tretët	28,637,780	12,393,609
Shpenzime qiraje	14,816,985	11,443,200
Shërbime doganore	11,933,719	11,320,636
Konsulenca dhe shërbime nga të tretë	9,852,503	9,054,290
Shpenzime për mirëmbajtje dhe riparime	7,793,193	8,608,227
Komisione rishitje	7,360,785	7,685,515
Shpenzime për energji, ujë, karburant etj.	6,457,045	4,961,156
Shpenzime të tjera administrative	4,940,553	9,292,244
Ruajtja dhe siguria	3,400,268	2,085,600
Taksa e tarifa vendore dhe të tjera si to	3,304,304	2,580,251
Vlera e aseteve të shitura	1,939,723	3,202,357
Shpenzime telekomunikacioni	1,277,975	1,317,620
Shërbime bankare	1,125,464	1,104,597
Udhëtime e dieta	900,761	1,584,219
Totali	224,192,673	171,894,274

18. SHPENZIME FINANCIARE NETO

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Fitime nga kurset e këmbimit	1,709,747	1,328,588
Humbje nga kurset e këmbimit	(6,004,175)	(4,349,703)
Totali i humbjeve nga kurset e këmbimit	(4,294,428)	(3,021,114)
Të ardhura nga interesat	-	-
Shpenzime për interesat	(472,190)	(561,431)
Totali i shpenzimeve për interesa	(472,190)	(561,431)
Shpenzime financiare neto	(4,766,618)	(3,582,545)



GTS-Gazra Teknike Shqiptare Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllt më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përvçese kur shprehet ndryshe

19. SHPENZIME TË TJERA

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Borxh i keq	20,123,766	-
Gjoba dhe penalitete	-	3,005,270
Shpenzime tatimi i mbajtur në burim	2,887,090	2,410,914
Shpenzime për personelin, të pazbritshme	535,149	551,439
Shpenzime të tjera të pazbritshme	2,436,696	2,307,183
Totali	25,982,701	8,274,806

20. TATIM FITIMI

Tatimi mbi fitimin në Shqipëri është vlerësuar në normën 15% (2016:15%) të të ardhurave të tatuveshme.

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Fitimi para tatimit	62,167,856	80,777,233
Shpenzime të pazbritshme	25,982,701	8,274,806
Fitimi tatimor për vitin	88,150,557	89,052,039
Tatimi mbi fitimin 15%	13,222,584	13,357,806
Fitimi neto i vtit	48,945,272	67,419,428

Shpenzimet e pazbritshme lidhen me shpenzime që sipas Ligjit Shqiptar nuk mund t'i zbriten llogaritjes së fitimit/humbjes së tatuveshme.

Më poshtë paraqitet rakordimi i normës efektive të tatimit:

	31 dhjetor 2017	Norma efektive tatimore	30 dhjetor 2016	Norma efektive tatimore
Fitimi për vitin	62,167,856		80,777,233	
Tatimi mbi fitimin duke përdorur normën fiskale	9,325,178	15.00%	12,116,585	15.00%
Shpenzime të pazbritshme	3,897,406	6.27%	1,241,221	1.54%
Totali i shpenzimit të tatimit mbi fitimin	13,222,584	21.27%	13,357,806	16.54%



GTS-Gazra Teknike Shqiptare Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllt më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përvçese kur shprehet ndryshe

21. TRANSAKSIONET ME PALET E LIDHURA

Shoqëria ka marrëdhëniet si palë e lidhur me shoqerinë mëmë dhe shoqëri brenda grupit.

Një përbledhje e balancave me palët e lidhura paraqitet më poshtë:

Të arkëtueshme nga palët e lidhura::

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
SOL Hellas S.A	14,120,600	13,952,738
SOL Bulgaria	4,099,114	4,169,411
SOL S.p.A Italia	10,863,610	-
TGS A.D	66,475	-
SPG –SOL Plin Gorenjska d.o.o.	5,377,828	-
	34,527,627	18,122,149

Të pagueshme ndaj palëve të lidhura:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
SOL SEE D.O.O	65,403,968	23,515,135
SOL S.p.A Italia	834,786	460,788
TGS A.D	24,752,348	8,210,851
SOL Hellas S.A	-	1,259,573
BEHRINGER S.r.l.	404,833	243,414
	91,395,935	33,689,761

Shitje

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
HydroEnergy Sh.p.k	161,400	257,460
SOL Hellas S.A	50,918,944	28,091,680
SOL SEE D.O.O	137,966,174	141,144,001
SPG –SOL Plin Gorenjska d.o.o.	5,403,329	-
SOL S.p.A Italia	34,192,891	-
SOL Bulgaria	-	4,169,411
TGS A.D	67,263	-
	228,710,001	173,662,552

Blerje

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
BEHRINGER S.r.l.	3,593,845	3,395,515
SOL SEE D.O.O	180,155,276	189,788,902
SOL Hellas S.A	12,227,964	9,978,025
SOL S.p.A	2,059,684	438,204
TGS A.D	16,846,646	17,072,631
SOL Welding S.r.l	1,129,091	-
	216,012,507	220,673,278



GTS-Gazra Teknike Shqiptare Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllt më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përvçese kur shprehet ndryshe

22. INFORMACION MBI RISQET

22.1 Manaxhimi i rrezikut finanziar

Nga përdorimi i instrumentave financiare Shoqëria është e eksposuar ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- Risku i kreditit – në lidhje me transaksionet normale të biznesit me klientët
- Risku i likujditetit – rreziku që Shoqëria do të hasë vështirësi në plotësimin e angazhimeve nga detyrimet e saj financiare
- Risku i tregut – në lidhje me kurset e këmbimit ose normave të interesit

22.2 Risku i kreditit

Pozicionet mes të llogarive të arkëtueshme tregtare për të cilat është konstatuar kthimi i pjesshëm ose i pjesshëm objektiv, i nënshtrohen reduktimit. Provigionet bëhen në baza kolektive për llogaritë e arkëtueshme që nuk janë subjekt i zhvlerësimit, duke marrë parasysh përvojën historike dhe të dhënrat statistikore.

22.3 Risku i likujditetit

Pikëpamja e Shoqërisë për manaxhimin e likuiditetit është për të siguruar, aq sa është e mundur, që ajo do të ketë gjithmonë likuiditet të mjaftueshëm për të përbushur detyrimet e saj në kohën e duhur, në të dyja kushtet si ato të rënda dhe normale, pa shkaktuar humbje të papranueshme ose rrezikun e dëmtimit të reputacionit të Shoqërisë.

22.4 Risku i kureseve të këmbimit

Rreziku i kurseve të këmbimit është një rrezik që rrjedh nga ndryshimi i çmimit të një monedhe kundrejt një tjetre. Rreziku i monedhës është manaxhuar duke monitoruar pozicionet e hapura valutore. Rreziku i monedhës drejtohet duke përdorur parimet e përputhjes aktive/detyrime. Shoqëria nuk ka pasur ndonjë mbrojtje si kontratë këmbimi 'forward' apo produkte derivative të integruara në kontrata më 31 dhjetor 2017 dhe 2016.

22.5 Risku i tatimit

Shoqëria është subject i taksimit në Shqipëri dhe ajo mund të jetë subjekt i vlerësimeve nga autoritetet fiskale Shqiptare.

23. NGJARJE PAS PERIUDHËS RAPORTUESE

Pas datës së pasqyrave financiare nuk ka pasur ngjarje për të cilat të nevojiten rregullime në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

